



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“Për miratimin e planit lokal, programit 5-vjeçar të Strehimit Social 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”

“Për miratimin e planit të Mbrojtjes Sociale 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”

“Për miratimin e planit lokal të Rinisë 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”

“Për miratimin e planit vendor të veprimit për Barazinë Gjinore 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”

Konsultim publik : I Hapur

Data : 18.02.2026

Ora : 13:30

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : 53, nga të cilët 43 gra,.

Titulli i projekt-aktit që konsultohet:

- “Për miratimin e planit lokal, programit 5-vjeçar të Strehimit Social 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”
- “Për miratimin e planit të Mbrojtjes Sociale 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”
- “Për miratimin e planit lokal të Rinisë 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”
- “Për miratimin e planit vendor të veprimit për Barazinë Gjinore 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër, banorë dhe grupe interesi. (Bashkëngjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak Shkodër Z.Oltion Luli, i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar ;
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik;
- ✦ Shtroi pyetje konkrete për pjesëmarrësit;
- ✦ Dha informacion mbi mënyrën e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve për të shprehur mendimet dhe sugjerimet e tyre.

Pjesëmarrësit që kontribuan në diskutim dhe dhanë rekomandimet e tyre mbi çështjen e trajtuar janë si më poshtë:

Fjalën e merr **Znj. Edita Shoshi**, drejtoreshë e përgjithshme e Shërbimit Social dhe Strehimit në Bashkinë Shkodër. Ajo bën një prezantim të planeve sociale, të cilat janë përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër, të asistuar nga ekspertë të jashtëm.

Po ashtu edhe **Znj. Teuta Qyteza**, zv.Kryetare e Bashkisë Shkodër në fjalën e saj falenderon gjithë stafin e Bashkisë për punën e kryer në hartimin e këtyre planeve dhe shpreh mirënjohje për ndihmën e ofruar nga ekspertët e jashtëm. Ajo thekson rëndësinë e këtyre planëve sociale për ofrimin e shërbimeve sa më efikente për qytetarët e Shkodrës.

Një prezantim të detajuar të këtyre planeve bën **Z. Michael Johnson**, menaxher projekti / menaxhimi i Shërbimeve Publike GOPA

Më tej fjalën e merr **Znj. Helga Smakaj**, përfaqësuese e SOS Fshatrat e Fëmijëve, e cila shprehet se propozimet dhe sygjërimet e tyre i kanë dërguar edhe me e-mail. Gjatë fjalës se saj evidentoi tre aspekte: komponenti i shërbimeve sociale ekzistuese dhe shërbimet e reja; roli dhe përfshirja e organizatave të shoqërisë civile. Për komponentin e shërbimeve ekzistuese për qendrat komunitare ajo sugjeroi parashikimin e pilotimit të modelit të fuqizimit të familjes meqenëse qendra komunitare bazohet në menaxhimin e rastit. Gjithashtu do të ishte me interes të kishte informacion se në sa për qind të zonave do të shtrihen këto qendra komunitare, cilat do të jenë prioritetet, grupmoshat dhe objektivat. Kjo sepse duke qenë plan 5 vjeçar edhe organizatat e shoqërisë civile kanë interes për këtë informacion në mënyrë që edhe planet afatgjata të tyre të jenë në përputhje me parashikimet e planit social.

Tjetër element që përmendi znj. Smakaj ishte shërbimi i kujdestarisë familjare. Në Shkodër ka disa institucione që kërkojnë deinstitutionalizimin dhe meqë forma kryesore e kësaj është kujdestaria profesionale e përkohshme, duhet që plani social të ketë një seksion të veçantë për këtë. Gjithashtu, plani social duhet të ketë një seksion të veçantë për rolin e shoqërisë civile dhe nëse do të ketë mundësi bashkëfinancimi. Znj. Smakaj kërkoi gjithashtu informacion lidhur me procesin e monitorimit të planit social.

Ndërsa për planin e Rinise ajo tha se përdorimi i të rinjve dhe organizatave rinore të mos kufizohet vetëm në fazën e konsultimit, por të institucionalizohet përmes mekanizmave të qartë të bashkëvendimmarrjes gjatë zbatimit dhe monitorimit të planit.

- Rekomandohet forcimi i rolit të Këshillit Vendor Rinor, duke i dhënë kompetenca konkrete në monitorimin e aktiviteteve dhe propozimin e iniciativave rinore.
- Bashkëpunimi me OJF-të duhet të specifikohet më qartë, duke përfshirë rolet, përgjegjësitë dhe format e ndërveprimit, si p.sh. marrëveshje partneriteti, thirrje për projekte ose bashkëzbatim aktivitetsh.
- Sugjerohet krijimi i një platforme të përhershme bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë dhe organizatave që punojnë me dhe për të rinjtë.
- Plani duhet të përfshijë masa konkrete dhe të matshme për të rinjtë nga zonat rurale, të rinjtë me aftësi të kufizuara, komunitetet rome dhe egjiptiane etj.
- Rekomandohet vendosja e indikatorëve të qartë për matjen e përfshirjes së këtyre grupeve.
- Dokumenti duhet të përfshijë një strategji të qartë për sigurimin e burimeve financiare afatgjata duke përdorur fonde të Bashkimit Evropian, programet IPA, Erasmus+, bashkëfinancime me donatorë, sektorin privat dhe buxhetin e shtetit.
- Raportet e monitorimit dhe vlerësimit duhet të jenë publike dhe të prezantohen periodikisht për të rinjtë dhe komunitetin, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe vetë të rinjtë si aktorë aktivë në këtë proces.
- Rekomandohet forcimi i lidhjes mes edukimit joformal, punës rinore dhe formimit profesional me nevojat reale të tregut të punës lokal.
- Sugjerohet thellimi i bashkëpunimit me AKPA, bizneset lokale dhe sipërmarrjet sociale për ofrimin e praktikave profesionale, mentorimit dhe mundësive të punësimit për të rinjtë.
- Plani duhet të krijojë mundësi më të gjera bashkëpunimi mes institucioneve publike, sektorit privat dhe organizatave të shoqërisë civile, duke përfshirë përfshirjen e tyre në programe praktike, mentorim, orientim në karrierë dhe punësim, me qëllim ndërtimin e urave më të forta mes të rinjve dhe tregut të punës dhe rritjen e ndikimit dhe qëndrueshmërisë së ndërhyrjeve.

Eksperti i GOPA – Michael Johnson, dha një përgjigje për një pjesë të sugjerimeve të znj. Smakaj, i cili konfirmoi rolin e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e shërbimeve sociale të Bashkisë dhe ofruese të tyre dhe ofrimin e trajnimeve për organizatat për këto aspekte.

Më hollësisht këtu flet **Znj. Rezarta Sheshaj**, eksperte vendore e “GOPA”, e cila theksoi sfidën për të pasur informacion sa më të saktë për shërbimet sociale. Për këtë prioriteti i dytë lidhet me realizimin e një studimi vlerësues për të gjitha shërbimet sociale në të gjithë Bashkinë për të

vlerësuar se ku do të orientohen shërbimet sociale dhe qendrat komunitare apo shërbimet multifunkionale. Për çdo masë të plani janë parashikuar aktivitete të kostueshme. Ne planin e veprimit janë parashikuar aktivitete ndërgjegjësuese për informimin e komunitetit për familjet kujdestare dhe të mbështeten dhe orientohen familjet potenciale që kanë dëshirë për të qenë familje kujdestare. Monitorimin e planit e realizon vetë bashkia por një element i rëndësishëm për monitorimin është shoqëria civile. Pas miratimit të planit social do të bëhet plani i detajuar I monitorimit. Organizatat e shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë lokalë dhe sektori privat janë përfshirë në planin social.

Në vazhdim fjalën e merr **Znj.Denada Shpuza**, Drejtore ekzekutive e qëndres “Hapa të Lehtë”, e cila shprehet se hartimi dhe prezantimi i këtyre planeve është një hap ambicioz dhe i rëndësishëm, duke e renditur Bashkinë Shkodër ndër bashkitë që kanë ndërmarrë një qasje të integruar dhe të avancuar në planifikimin social për periudhën 2026–2030. Megjithatë, pavarësisht ambicies dhe punës së realizuar, Qendra e Gruas dëshiron të paraqesë disa rekomandime për përmirësim, me qëllim integrimin e tyre në këto dokumente strategjike.

Ajo shtoi se mungonte një analizë e planit social të mëparshëm se çfarë ka funksionuar dhe çfarë jo. Ajo pyeti nëse do të rishikoheshin referencat në planin e prezantuar të strategjive kombëtare që i ka përfunduar vlefshmëria kohore me ato të rejat që do të miratohen. Ajo evidentoi se në plan mungonte një program i vecantë për viktimat e dhunës në familje, megjithëse trajtohen si grup vulnerabël dhe të gjitha shërbimet janë të ndara si shërbime sociale të përgjithshme. A parashikon Bashkia ngritjen e një mekanizmi në mbështetje të viktimave të dhunës në familje? Aktualisht nuk ka të dhëna për shërbimet e ofruara nga Bashkia ndër vite për këtë kategori. Gjatë monitorimit të planit social sugjerohet të dilet edhe me disa indikatorë gjinorë të shërbimeve të ofruara.

Rekomandimet tona, thotë ajo mbështeten në kuadrin ligjor në fuqi dhe burojnë nga dëshira për të kontribuar në forcimin e shërbimeve sociale cilësore për të gjitha grupet në nevojë, veçanërisht për gratë dhe vajzat viktimat të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi ynë i vetëm nepermjet ketyre rekomandimeve është që Bashkia Shkodër të ofrojë shërbime cilësore të qëndrueshme dhe të konsolidohet si model frymëzimi në fushën e politikave sociale edhe për bashki të tjera në vend. Fillimisht, do të vlerësonim shumë që Plani i Mbrojtjes Sociale të paraqiste qartë parimet mbi të cilat është mbështetur dhe nga të cilat udhëhiqet puna e Bashkisë. Mungesa e një artikulimi të qartë të këtyre parimeve nuk e cenon thelbin e planeve, por do t’u jepte atyre një vlerë të shtuar përballë institucioneve partnere dhe donatorëve. Ashtu siç u theksua edhe gjatë procesit të konsultimit publik, e konsiderojmë të rëndësishme që këto plane të parashikojnë mundësinë e rishikimit dhe integritit të tyre periodik, duke qenë se disa prej dokumenteve mbi të cilat ato mbështeten¹ kanë përfunduar afatin e zbatimit ose janë ende në proces miratimi. Për këtë arsye, duhet të përcaktohen qartë mekanizmat dhe procedurat e rishikimit të këtyre planeve. Plani i Mbrojtjes Sociale nuk përmban një analizë të qartë të arritjeve dhe sfidave në zbatimin e planit të mëparshëm social. Për këtë arsye, Bashkia duhet të realizojë çdo vit një raportim të detajuar mbi zbatimin e të gjitha planeve, duke përfshirë indikatorë gjinorë në mënyrë të detyrueshme gjatë procesit të raportimit. Gjithashtu, rekomandohet saktësimi dhe përditësimi i të dhënave mbi

popullsinë, pasi popullsia përbën një indikator thelbësor në planifikimin dhe hartimin e strukturave dhe shërbimeve sociale. Një analizë e saktë demografike ndikon drejtpërdrejt në përcaktimin e nevojave reale, dimensionimin e kapaciteteve institucionale, shpërndarjen e burimeve financiare dhe ngritjen e strukturave të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve. Ne vlerësojmë se cdo objektiv strategjik duhet të shoqërohet me indikatorë të tipit SMART (Specifikë, të Matshëm, të Arritshëm, Realistë dhe të përcaktuar në Kohë), në mënyrë që të garantohet monitorim efektiv dhe vlerësim i saktë i progresit. Gjithashtu, sugjerohet parashikimi i publikimit të një Raporti Vjetor të Integruar Social, i cili të përmbledhë progresin e të gjitha planeve strategjike në një dokument të vetëm, të strukturuar dhe transparent për qytetarët, institucionet partnere dhe donatorët. Ky raport do të forconte llogaridhënien publike dhe do të rriste besimin në procesin e planifikimit dhe zbatimit të politikave vendore.

Pavarësisht faktit që Bashkia Shkodër ka hartuar katër plane ambicioze, konstatojmë se viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore përmenden si pjesë e grupeve vulnerabël, por nuk evidentohen masa konkrete apo kuota të dedikuara për to në rastin e strehimit, mbështetjes ekonomike, përjashtimit nga taksat apo tarifat e regjistrimit në kopshte, çerdhe, apo në masa të tjera lehtësuese.

Përsëri **Znj. Sheshaj**, sqaron në lidhje me problematikën e mungesë se të dhënave statistikore. Indikatorët gjinore janë përfshirë, por do të sigurohet që të jenë në të gjithë indikatorët

Znj. Shllaku, anëtare e Këshillit Bashkiak, tha se kishin dërguar pranë Bashkisë një shkresë me pyetje dhe sugjerime për planet që ishin për konsultim. Plani social duhet të përmbajë analizën e nevojave, bazuar në disa të dhëna demografike, si: numri i popullsisë, shkalla e papunësisë, numri i përfituesve të ndihmës ekonomike, numri i personave me aftësi të kufizuara, etj. Këto të dhëna mungojnë ose janë të viteve 2021, 2022 dhe 2023. Numri i familjeve të mbështetura për strehimin social është i viteve 2018–2022, ndërsa numri i fëmijëve që ndjekin arsimin e mesëm për vitin 2022–2023. Në plan duhet të parashikohet edhe zgjerimi i hartës së shërbimeve dhe sa shërbime të reja sociale parashikon Bashkia, si dhe cilat janë ato. A ka vlerësim të gjendjes aktuale të të moshuarve në nevojë dhe pa mbështetje familjare? Çfarë do të bëjë konkretisht Bashkia për shërbimet në shtëpi për të moshuarit që jetojnë vetëm dhe me probleme të ndryshme? A ka një paketë emergjence për viktimat e dhunës, me masat dhe buxhetin e nevojshëm? A ka një vlerësim për personat me aftësi të kufizuara?

Në përfundim, ajo shprehet se konsideron se këto plane duhet të jenë të bazuara në të dhëna të përditësuara, të buxhetuara, të matshme dhe të monitorueshme, në mënyrë që të mos mbeten dokumente formale, por instrumente reale zhvillimi për qytetarët e Bashkisë Shkodër.

Më pas fjalën e merr **Znj. Mira Prekperaj**, përfaqësuese Komunitetit Papa Xhovani I XXIII, e cila fillimisht falënderon për punën dhe angazhimin cilësor në hartimin e planeve sociale dhe shton se do të cilësonte tre ndërhyrje.

Së pari do dëshironim shumë ti jepej një vëmendje e veçantë kujdestarisë alternative në qytetin e Shkodrës duke besuar fort se qyteti ka mjaft familje potenciale kujdestare qofshin ato me lidhje gjaku apo dhe pa lidhje gjaku. Gjithnjë e më shumë po e shikojmë në menaxhimet e rasteve ku ka të mitur sa lehtësuese dhe "shëruese" mund të jetë përfshirja e familjes kujdestare.

Komuniteti Papa Xhovani I XXIII ka mbi 53 vite (në nivel ndërkombëtar) që ofron shërbimin e kujdestarisë familjare në Itali dhe në vende të tjera dhe mund të jemi të gatshëm të ndihmojmë dhe lehtësojmë e gjithë ngritjen e shërbimit të kujdestarisë alternative në Bashkinë Shkodër duke sjellur praktikat pozitive dhe mbështetur gjithë procesin në vetvete.

Së dyti, Komuniteti Papa Xhovani i përgjigjet të gjitha rasteve dhe kërkesa për mbështetje të rasteve të viktimave të dhunës në familje të Bashkisë Shkodër me dy qendrat rezidenciale të saj, qoftë nevoja emergjente apo atyre afatgjata të cilat shkojnë deri në disa vite. Do dëshiroja ta shikoja të buxhetuar në njërin nga zerrat në planin social duke i konsideruar këto dy qendra si të vetmet qendra rezidenciale afatgjata jo vetëm për Viktimat e dhunës në familje për Shkodrën, por edhe për grupe të tjera në nevojë.

Së fundmi në një prespektive më afatgjatë do sygjeroja të merrej në konsideratë ngritja e një shërbimi rezidencial dhe ditor për personat me varësi nga substancat narkotike, alkooli dhe lojrat e fatit duke marrë parasysh që organizata jonë ka mbi 35 vite ekspertizë në ofrimin e këtij shërbimi. Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë si në ngritjen e këtij shërbimi apo dhe në dy sygjerimet e mësipërme për tu përgjigjur nevojave në komunitet.

Stela Tanellari, përfaqësuese e organizatës "Të ndryshëm dhe te barabartë", tha se kishin dërguar disa sugjerime me shkrim pranë Bashkisë për të katër planet e prezantuar së bashku me një model integrimi për viktimat e trafikimit. Ajo tha se ishte e nevojshme, që për shërbimet sociale gjithëpërfshirëse të parashikuara të garantohet mundësia të jepen në vazhdimësi, pa ndërprerje.

Ndërsa për Planin Lokal për Barazinë Gjinore 2026–2030 fjalën e merr:

Z. Fatjon Taipi, përfaqësues i Zyrës për djem dhe burra Shkodër, i cili sugjeroi të shtohen elementët e rinj të ligjit për barazinë gjinore të ndryshuar. Ai evidentoi se plani i prezantuar ka një fokus të kufizuar për djemtë dhe burrat.

Ekspertja e UNWOMEN **Znj.Monika Kocaqi** në përgjigje të komenteve tha se ligji i ri për barazinë gjinore ka parashikuar 6 muaj kohë nga miratimi për hartimin e aktet nënligjore për zbatimin e dispozitave të reja të ligjit. Ndaj ishte e vështirë të bëhej një reflektim i tyre në këtë plan momentalisht. Ajo gjithashtu pranoi që plani ka një fokus të kufizuar për djemtë dhe burrat.

Për Planin Lokal të Rinisë 2026–2030 flet specialistja e zyrës së Shërbimit Social Shkodër **Znj.Aledija Onuri**, e cila tha se institucioni kishte dërguar komentet me shkrim pranë Bashkisë. Gjithashtu shton se ishte e nevojshme të parashikohet një sistem i unifikuar referimi për të rinjtë që nuk ndjekin shkollën e mesme dhe se Bashkia duhet të jetë gjithashtu pjesë e këtij sistemi. Po

ashtu është e nevojshme për të adresuar shërbimet dhe ndërhyrje për përmirësimin e shëndetit mendor. Gjithashtu ajo tha se ishte e nevojshme të bëhej një hartëzim i shërbimeve aktuale për të rinjtë dhe specifikim i fondeve për organizatat e shoqërisë civile që mund të ofrojnë shërbime.

Znj. Arlinda Bilali, drejtoreshë e Shërbimit Social në Bashkinë Shkodër sqaroi, që do të ngrihet një sistem i unifikuar referimi të rasteve.

Po ashtu edhe **Znj. Mirza Berdica**, përgjegjëse pranë drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Shkodër sqaroi se njëri prej objektivave strategjike bashkë me masat përkatëse trajton edhe shëndetin mendor të rinjtë.

Znj. Edlira Muhedini, përfaqësuese e SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, u shpreh se kishin dërguar me shkrim pranë Bashkisë disa komente për Planin Lokal të Rinisë edhe në kuadër të një projekti që SOS kishte filluar zbatimin në Shkodër dhe Tiranë.

Përsëri **Z. Fatjon Taipi**, përfaqësues i Zyrës për djem dhe burra Shkodër, shtoi se në plan duhen parashikuar masa edhe për të rinjtë (të miturit) në konflikt me ligjin për masa parandaluese ose rehabilituese.

Glorja Shllaku, anëtare e KB Shkodër, kërkoi informacion lidhur me politikat e Bashkisë për frenimin e emigracionit të rinjve dhe planet parandaluese në këtë drejtim. Gjithashtu kërkoi informacion lidhur me marrëveshje me AADF/BID se në cilën fazë është procesi.

Përgjigjet **Znj. Mirza Bërdica**, duke informuar lidhur me statusin e nënshkrimit të marrëveshjeve që nuk ishte finalizuar ende. Plani ka të parashikuar masa për orientimin e rinjve në tregun e punës.

Gjithashtu kishte një koment lidhur me saktësimin e të dhënave demografike të përdorura si referencë Censi apo të dhënat e gjendjes civile për Bashkinë Shkodër.

Për Planin Lokal të Strehimit Social 2026–2030, nuk pati komente dhe sygjerime.

Pyetje dhe diskutime të tjera nga të pranishmit nuk ka . Dëgjesa publike deklarohet e mbyllur.

SEKRETARE

Sabina Danaj

Zbardhi procesverbalin:

Bekim Mema

Irma Sulishti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

KONSULTIM PUBLIK:

LISTË PREZENCË

Data: 18.02.2026

1. “Për miratimin e planit lokal, programi 5-vjeçar të Strehimit Social 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”.
2. Projektvendim: “Për miratimin e planit lokal të Barazisë Gjinore, Rinisë dhe Mbrojtjes Sociale 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”.

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJA/ESHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Stela Tonellari	Të Noliqiem & Të Rodatit	0684033663	stela.tonellari@shkodra.gov.al	
2.	Enina Adeau	UN WOMEN	0692074150	enina.adeau@unwomen.org	
3	Dionanda Vito	UN Women/Eksperte	0692054622	dionanda.vito@unwomen.org	
4	Monika Kougi	UN Women/Eksperte	0686188010	monika.kougi@unwomen.org	
5	Kenda Selimaj	B. Shkodër	0684308727	kenda.selimaj@shkodra.gov.al	
6	Fortmira Shiroja	B. Shkodër	0692645745	fortmira.shiroja@gmail.com	
7	Glorya Sullaku	B. Shkodër	0687384873	glorya.sullaku80@gmail.com	

NR.	EMRI MBEMRI	LAGJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
8	Gjenari Kapari	B. Shkoder	0672288236	gjenari.kapari@chmail.com	
9	Flurida Taji	B. Shkoder	068216776	elezajo@belmail.it	
10	Jonida Kuti	B. Shkoder	0682840893	jonidakuti@gmail.com	
11	Olinda Duku	B. Shkoder	0675191621	olindaduku@gmail.com	
12	Rosa Syreni	B. Shkoder	0673680440	rosasyreni@gmail.com	
13	Julia Cini	B. Shkoder	0694258000	juliacini@falcone.it	
14	Suada Agori	B. Shkoder	0693226526	suadaagori@gmail.com	
15	Fajon Taji	Shkoder / ZDB	0692778704	f.taji@zdb.al	
16	Tonida Cela	B. Shkoder	0697820410	celatonida@gmail.com	
17	Jonie Bashi	Shkoder / GTG	0696224010	joniebashi@gmail.com	
18	Jonida Bepi	B. Shkoder	0687048186	edvalde.bepi@balkanidhpa.gov.al	
19	Grinda Kurtaj	B. Shkoder/Maltesa	0698919575	erisb.kurtaj@maltesa.al	
20	Jonie Bektash	B. Shkoder/Maltesa	0693880235	jonie.bektash@maltesa.al	
21	Jonie Zgure	QGT	067406001	joniezgure@gmail.com	
22	Donalda Boshota	QGT	0677411860	donaldaboshota@gmail.com	
23	Dana Marku	B. Shkoder/MISHK	0685875232	markudana68@gmail.com	
24	Sabina Shabaj	B. Shkoder/MISHK	0677282402	shabajsabina@gmail.com	
25	Alma Shpati	B. Shkoder/MISHK	0663383366	almapatiti4@gmail.com	
26	Muhammed Fusi	F. Shkoder/MISHK	0685222698	xhuan.keqaj@unishk.edu.al	
27	Elvis Makellari	Tirane	0682564548	elvis.makellari@tkl.org	

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
28	Shemsi Shkoder	SHKODËR	0692938017	shemsi.shkoder@gmail.com	
29	Juliana Jona	SHKODËR	0692148435	julianajona@gmail.com	
30	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0674463330	shkoder.shkoder@gmail.com	
31	Shkoder Shkoder	SHKODËR	067883244	shkoder.shkoder@gmail.com	
32	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0674201246	shkoder.shkoder@gmail.com	
33	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0689343419	shkoder.shkoder@gmail.com	
34	Shkoder Shkoder	SHKODËR	068242650	shkoder.shkoder@gmail.com	
35	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0685274880	shkoder.shkoder@gmail.com	
36	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0697036665	shkoder.shkoder@gmail.com	
37	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0696089130	shkoder.shkoder@gmail.com	
38	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0698361033	shkoder.shkoder@gmail.com	
39	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0674518200	shkoder.shkoder@gmail.com	
40	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0672014420	shkoder.shkoder@gmail.com	
41	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0692020144	shkoder.shkoder@gmail.com	
42	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0686555655	shkoder.shkoder@gmail.com	
43	Shkoder Shkoder	SHKODËR	06902499	shkoder.shkoder@gmail.com	
44	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0698719852	shkoder.shkoder@gmail.com	
45	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0673842437	shkoder.shkoder@gmail.com	
46	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0687445050	shkoder.shkoder@gmail.com	
47	Shkoder Shkoder	SHKODËR	0696136116	shkoder.shkoder@gmail.com	

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJAFSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
48.	Bujar Bexhetari	Shekter	0676358044	bujar.bexhetari@beshkter.com.al	
49	Donata 2019	Shekter.	0673370001	donata2019@beshkter.com.al	
50	Tanda Shkollë	Tirane SOFT	0652428707	tanda.shkoll@beshkter.com.al	
51	Edlira Shkollë	SOFT.Tirane	0692087831	edlira.shkoll@beshkter.com.al	
52	Heser Tetihë	Shekter.	0695705614	heser.tetih@beshkter.com.al	
53.	Blendi Yeli	Shekter	0675242544	blendi.yeli@beshkter.com.al	